



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:166482
Datë: 29.07.2023
Numri i dokumentit: 04535392

C.nr. 848/17.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari, Migjen Kastrati, në çështjen juridike kontestimore të paditësit L.D, nga fshati B, Komuna e Pejës, të cilin e përfaqëson Esat Muharremi, avokat në Pejë, kundër të paditurit, D.D, nga fshati B, Komuna e Pejës, tani me adrese të vendbanimit në K, Republika e Serbisë, me bazën juridike, për vërtetim të pronësisë, vlera e kontestit: 1.000 euro, jashtë seancës gjyqësore me datën, 29.07.2023, morri ketë :

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET SI E TËRHEQUR** padia me numër C.nr. 904/19 e datës, 01.08.2019, e paditësit, H (R) K, nga V R....., Komuna e Pejës, e ushtruara kundër të paditurit, R.(s) S, nga, Komuna me bazën juridike, me bazën juridikë për vërtetim të pronësisë, vlera e kontestit: 1.000 euro.

A r s y e t i m

Paditësi pranë gjykatës me datën, 01.08.2019, ka parashtruar padi nëpërmjet të autorizuarit të tij, kundër të paditurit, me bazën juridike për vërtetim të pronësisë, vlera e kontestit: 1.000 euro.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë dhe përgatitjes për shqyrtim gjyqësor, si dhe provave prezentë në lende, aktvendimin për përgjegjës në padi padinë dhe provat i ka dërguar të paditurit në adresën si në padi, mirëpo gjykatës i është kthyer dërgesa me konstatimin se pala nuk është në V i shpërngulur 13.03.2023, me anë të aktvendimit të veçantë padinë i ka kthyer në plotësim- korrigjim paditësit respektivisht të autorizuarit të tij, av. Osman Cucoviq, me C.nr. 904/19 të dt. 30.06.2023, për plotësimin e padisë për sigurimin e adresës së sakte vendbanimit apo të vendqëndrimit për të paditurin, dhe brenda afatit ligjore prej, 3 ditësh, gjykatën ta njoftoj me adresën e sakte për të paditurit, duke u njoftuar edhe për pasojat ligjor në rast të mos veprimit.

I autorizuari i paditësit me datën, 30.06.2023 e ka pranuar aktvendimin për plotësim në mënyre të rregullte dhe brenda afatit të përcaktuar me këtë aktvendim nuk ka vepruar.

Me dispozitën e nenit 99.2 të LPK-së, shprehimisht është përcaktuar se: Parashtrësia duhet të jenë të kuptueshme dhe të përmbajnë çdo gjë që nevojitet dhe e mundëson veprimin sipas tyre. Ato duhet të përmbajnë sidomos: emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin (emërtimin e personit juridik), vendbanimin apo vendqëndrimin (selinë e personit juridik) e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor apo me prokurë, po që se i kanë, objektin e kontestit, përmbajtjen e deklaratës dhe firmën e parashtrësit. Me dispozitën e nenit: 102.1 të LPK- së, në mënyrë specifike është cekur se: Kur një parashtrësë nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do ta thërrasë personin që e dërgon ta korrigjojë ose ta plotësojë parashtrësën. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për korrigjimet dhe për plotësimet që do të zënë vend dhe e cakton një periudhë treditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtrësës ”.

Ndërsa me dispozitën 102.2 të LPK - së, është cekur se : Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësia do të hidhet poshtë. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për korrigjime dhe plotësimet që do të zënë vend dhe e cakton një periudhë 3 ditore për korrigjon dhe për plotësimin e parashtrësës. Me dispozitën e nenin: 102.3 parashihet se do të konsiderohet e tërhequr parashtrësia po qese nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar e në qoftë se kthehet pa u korrigjuar , gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësia do të hidhet poshtë.

Meqenëse pala paditëse respektivisht i autorizuari i tij nuk ka vepruar në kuptim të vërejtjes për plotësimin e padis, gjykata duke u mbështetur në dispozitat e nenit: 99.2, 102.1 dhe 3, 142.1 dhe 2, 387.1, pika w), të LPK-së, gjykata vendosi si në diapozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:166482, C.nr. 904/19 i dt. 29.07.2023

Gj y q t a r i
Migjen Kastrati

Udhëzim Juridik:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes të kësaj gjykate.